



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PËRMBARUESI GJYQËSOR PRIVAT BESNIK BAJRAKTARI

Nr. 639/75 i Aktit

Tiranë, me 19.11.2020

**URDHËR**  
**PËR HEQJEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE**

**Drejtuar :** QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT (Q.K.B)

**Për dijëni:** debitorit Shoqëria “Ekspres-Beton Lezhë” sh.p.k

dorëzanësit Gjyste Gjinaj

dorëzanësit Pashk Gjinaj

dorëzanësit Mark Gjinaj

dorëzanësit Shoqëria “Beton-Ekspres” sh.p.k

kreditorit Banka Kombëtare Tregtare sh.a



Unë Besnik Bajraktari, me detyrë përmbarues gjyqësor privat pranë shoqërisë përmbarimore “Besnik Bajraktari” sh.p.k, me numër identifikimi L51526008U, nr. liçence 56, datë 21.09.2010, pasi studiova dosjen përmbarimore nr. 639 datë 15.12.2014, që i'u përket palëve me:

**Kreditor :** Banka Kombëtare Tregtare sh.a

**Debitor :** Shoqëria “Ekspres-Beton Lezhë” sh.p.k

**Dorëzanës:** Gjyste Gjinaj, Pashk Gjinaj, Mark Gjinaj, “Beton-Ekspres” sh.p.k

**Objekt :** Kthim shume, rrjedhur nga kontrata e kredisë bankare

**KONSTATOVA :**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka lëshuar urdhërin e ekzekutimit me vendimin nr. 15 datë 24.01.2012, për zbatimin e titullit ekzekutiv Kontratë Kredie Bankare Nr. 2627 Rep. Nr. 446 Kol. datë 21.04.2011 dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka lëshuar urdhërin e ekzekutimit me vendimin nr. 302 datë 05.09.2014, për zbatimin e titullit ekzekutiv Kontratë Kredie Bankare Nr. 2790 Rep. Nr. 2255 Kol. datë 31.07.2012, në bazë të cilit debitori Shoqëria “Ekspres-Beton Lezhë” sh.p.k dhe dorëzanësit Gjyste Gjinaj, Pashk Gjinaj, Mark Gjinaj, Shoqëria “Beton-Ekspres” sh.p.k, janë të detyruar të paguajnë në favor të kreditorit Banka Kombëtare Tregtare sh.a detyrimin në vlerën 33 270 849 lekë, ku përfshihet detyrimi sipas titullit ekzekutiv si dhe shpenzimet përmbarimore.

*Me Kërkesën Nr. 5826 Prot. datë 18.11.2020 të kreditorit Banka Kombëtare Tregtare sh.a kërkohet pushimi i ekzekutimit të titujve ekzekutivë të mësipërm.*

**PËR KËTO ARSYE**  
Në referim të nenit 616/b të K.Pr.Civile

**URDHËROJ :**

1. Heqjen e masës së sekuestros konservative, të vendosur me urdhërin nr. 639/21 Akti, datë 07.01.2015, mbi të gjitha aksionet/kuotat e regjistruara në emër të debitorit dhe dorëzanësit si më poshtë:

-Shoqëria “Ekspres-Beton Lezhë” sh.p.k me NIPT K58515501V

-Shoqëria “Beton-Ekspres” sh.p.k me NIPT K02327001F.

2.Për veprimet ose mosveprimet tuaja, duhet të na vini në dijeni brenda 5 ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

3.Në rast të kundërt, ndaj personave shkaktarë, do të aplikojmë gjobë në masën 50,000 lekë, në bazë të nenit 606 të K.Pr.Civile.



**PËRMBARUESI GJYQËSOR**  
**Besnik Bajraktari**